



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
Nr/Br. 36/20
Datë/Datum. 03.02.20
PRISHTINË - PRISTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH. nr. 36/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje: z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, dhe z. Goran Milenkovič - Anëtar, si dhe duke u bazuar në nenin 30 të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2017 të dt: 20.03.2017, pas shqyrtimit të kërkesës së datës 27 janar 2020, të parashtruar nga OE “Sinjalizimi” shpk, për tërheqje të ankesës me numër 36/20 të datës 16 janar 2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizimi, prodhimi dhe vendosja e numrave të adresave në Komunën e Prishtinës-Ritender”, të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktues- Kuvendi Komunal Prishtinës, me datën 29 janar 2020, bie këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, kërkesa e datës 27 janar 2020 e operatorit ekonomik OE “Sinjalizimi” shpk për tërheqjen e ankesës me nr. 36/20, e datës 16 janar 2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizimi, prodhimi dhe vendosja e numrave të adresave në Komunën e Prishtinës- Ritender”, të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktues- Kuvendi Komunal Prishtinës.

II. NDËRPREHET, procedura e shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik “Sinjalizimi” shpk, për tërheqje të ankesës me numër 36/20 të datës 16 janar 2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizimi, prodhimi dhe vendosja e numrave të adresave në Komunën e Prishtinës- Ritender”, të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktues- Kuvendi Komunal Prishtinës.

III. I LEJOHET, autoritetit kontraktues, që të vazhdoj më tutje me këtë aktivitet të prokurimit përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Meqenëse aprovohet tërheqja nga ankesa e OE ankues, të njëjti i kthehet tarifa që ka paguar me rastin e parashtrimit të ankesës.

V. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori Ekonomik "Sinjalizimi" shpk ka parashtruar ankesë në OSHP me datën 16 janar 2020, me nr. protokollit 19/20, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi, prodhimi dhe vendosja e numrave të adresave në Komunën e Prishtinës- Ritender", të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktues- Kuvendi Komunal Prishtinës, duke pretenduar se AK-ja ka bërë shkelje të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092.

Organi Shqyrtues i Prokurimit nga Tavolina Ndihmëse e KRPP me datën 27 janar 2020 përmes parashtrësës më shkrim është njoftuar OSHP-në se ankesa për aktivitetin e prokurimit "Furnizimi, prodhimi dhe vendosja e numrave të adresave në Komunën e Prishtinës- Ritender" me numër të prokurimit 616-19-9007-111, të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktues- Kuvendi Komunal Prishtinës është tërhequr me datën 15 janar 2020.

Poashtu Operatori ekonomik me datën 27 janar 2020 ka njoftuar OSHP që tërhiqet nga ankesa e parashtruar me datën 16 janar 2020 për shkak se të njëjtit kanë angazhime tjera.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 29 janar 2020, pa praninë e palëve konform nenit 26.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, ankesa e operatorit ekonomik, parashtrësja me shkrim e tavolinës Ndihmëse të KRPP si dhe të gjithë parashtrësja e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas analizimit të dokumentacionit të lëndës, konstaton se OE ankues ka parashtruar ankesën me numër 36/20 për aktivitetin e prokurimit "Furnizimi, prodhimi dhe vendosja e numrave të adresave në Komunën e Prishtinës- Ritender" me numër të prokurimit 616-19-9007-111, të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktues- Kuvendi Komunal Prishtinës. Pas pranimit OSHP konform nenit 113 të LPP-së ka autorizuar me datën 16 janar 2020 ekspertin shqyrtues për të analizuar dhe shqyrtuar pretendimet

ankimore. Eksperti shqyrtues me datën 23 janar 2020 ka dorëzuar raportin e ekspertizës. Paneli shqyrtues konstaton se OSHP përmes email-it ka pranuar parashtresën e Tavolinës Ndhimese të OSHP-së me të cilën ka njoftuar panelin shqyrtues se e ka tërhequr OE ankues ankesën nga sistemi i e prokurimit. Po ashtu me datën 27 janar 2020 ka pranuar parashtresën e OE ankues që ka njoftuar se kërkon që të tërhiqet nga ankesa.

Paneli shqyrtues i OSHP-së, pasi shqyrtoj kërkesën e operatorit ekonomik ankues, të njëjtën e aprovoj si të bazuar, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.



Vendimi i dërgohet:

- 1x1 AK- Kuvendi Komunal Prishtinës;
- 1x1 Operatorit ekonomik ankues;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim ne ueb faqe të OSHP-së.